

FJALA E DEPUTETIT FLAMUR NOKA

E ENJTE DATA 18 MAJ 2023

Sot është një ditë kur çdo shqiptar i ndershëm duhet të jetë kryeulur kur analizon dhe shikon që para 2 ditësh u mbyll procesi më i turpshëm në historinë e Shqipërisë për sa u përket të ashtuquajturave “proceset zgjedhore”. Ditën e diel, në datën 14 maj, në Shqipëri nuk kishte zgjedhje, por kishte thjesht një proces votimi. Ditën e diel ju konfirmuat se këtu nuk ekziston një qeveri demokratike, sikundër duhet të ketë në çdo vend me demokraci të konsoliduar. Dita e diel konfirmoi se në Shqipëri ka një regjim, një narkoregjim. Ditën e diel u tregua se në Shqipëri vija ndarëse mes partisë, pushtetit dhe shtetit nuk ekziston. Në Shqipëri parti-shtet ishin të gjithë: krimi, paraja e krimit, paraja e korrupsionit, paraja e drogës Shërbimi Informativ, policia, ushtria ishin garnizon i Partisë Socialiste për të blerë, për të vjedhur, për të dhunuar, për të terrorizuar dhe për të përçudnuar procesin e quajtur “zgjedhor”, vetëm e vetëm me një kusht: “Rilindja” të merrte 100% të pushtetit. Pra, banda, e quajtura “qeveri”, ditën e diel shkoi në zgjedhje me një moto: “Të gjithë pushtetin sovjetëve!”. Nuk kishte gjë më të neveritshme. Nuk kishte asnjë arsye që në Shqipëri të ndodhte një gjë e tillë, por pse? Sepse kjo tregon mentalitetin. Edi Rama dhe kjo qeveri kanë një mentalitet obskurantist. Nuk ishte imagjinuar ndonjëherë që Kryeministri t’u thoshte shqiptarëve: “Po votuat opozitën, do t’u lëmë pa ujë, pa bukë dhe pa drita”. Kjo gjë kalon edhe kufijtë e njerëzores, se të politikës po e po. Jeni duke e çuar Shqipërinë në skajet e të pamundurës për të duruar, jeni duke u thënë shqiptarëve që ne ju shkelim dhe ju konsiderojmë si vemje. Këta mekanizma që keni përdorur ju, i përdor vetëm mafia. Nuk ka vend në botë, ku një pushtet përdor instrumente të tilla kriminale, antiligjore, vetëm e vetëm për të marrë bashkitë. Elbasani e tregoi qartësisht këtë. Çfarë bëtë në Belsh me të burgosurit, duke i vënë të votojnë nga tri-katër herë?! I merrnit nga Durrësi për të votuar në Rrogozhinë. I çonit të votonin në Belsh vetëm e vetëm që i gjithë pushteti t’u kalonte sovjetëve.

Pra, ju përfundimisht, Edi Rama, kjo qeveri dhe kjo “Rilindje” nuk takoheni asgjëkund me votën e lirë. Nuk keni kurrfarë pikëtakimi me të. Jeni një regjim kriminal, kështu që bëhuni gati, sepse do t’ju përgjigjemi, ashtu siç e meriton një regjim kriminal dhe një bandë kriminale. Nuk ka më asnjë rrugë tjetër me ju. Nuk ka shqiptar që nuk e provoi. Shkoi kursi i euros 100,09 lekë. A jeni në vete?! Kurrë nuk ka rënë kursi i euros në këtë nivel. Po çfarë ishte kjo? Më e pakta ishin 500 milionë euro të korrupsionit tuaj dhe të krimit, që u hodhën. Pse? Për të vrarë votën e lirë. Juve nuk ju lidh asgjë me demokracinë e me votën e lirë, ndaj prisni përgjigjen. Përgjigjja do të jetë ajo që meriton çdo bandë, qoftë me pushtet e qoftë pa pushtet.